Nr. 28 prot
Dt. 02/10/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

# VENDIM

Nr. 21, datë 26.09.2023

**PËR**

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE MIRATIMIN E KËRKESËS PËR NDRYSHIMIN E KUSHTEVE TË LEJES NR.272/1 PROT., DATË 20.06.2018 HEC PLEPI TË SHOQËRISË "DOMI TEC" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

**V E N D O S I:**

1. Saktësimin e koordinatave të lejes me Nr.272/1 prot., datë 20.06.2018, miratuar me vendimin Nr.2, datë 13.06.2018 nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë si më poshtë:

HEC "PLEPI"

a) Koordinatat e Veprës së Marrjes nr.1, do të ndryshohen si më poshtë:
Nga:
- X= 4443838; Y= 4586238.22; Z= 1503.4 m.m.n.d. (Gauss Kruger)

**Në :**
**- X= 4443785; Y= 4586241; Z= 1503.4 m.m.n.d.(Gauss Kruger)**
**- X= 527268; Y= 4585942; Z= 1503.4 m.m.n.d. (KRGJSH)**

b) Koordinatat e Veprës së Marrjes nr.2, do të ndryshohen si më poshtë:

Nga:
- X= 4445084.02; Y= 4585799.94; Z= 1322 m.m.n.d. (Gauss Kruger)

**Në :**
**- X= 4445059; Y= 4585814; Z= 1322 m.m.n.d.(Gauss Kruger)**
**- X= 528547; Y= 4585530; Z= 1322 m.m.n.d. (KRGJSH)**

c) Koordinatat e Godinës së Centralit do të ndryshohen si më poshtë:

Nga:
- X= 4445952.34; Y= 4585197.59; Z= 1015 m.m.n.d. (Gauss Kruger)

**Në :**
**- X= 4445967; Y= 4585187; Z= 1015 m.m.n.d. (Gauss Kruger)**
**- X= 529462; Y= 4584913; Z= 1015 m.m.n.d. (KRGJSH)**

2. Miratimin e kërkesës për ndryshimin e kushteve të lejes Nr.272/1 prot., datë 20.06.2018, miratuar nga KBU Drinë-Bunë me Vendimin Nr.2, datë 13.06.2018 Leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik HEC PLEPI, me koordinatat e nënobjekteve të saktësuara dhe me zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së lejes sa Kontrata e Koncesionit,të shoqërisë "Domi Tec" sh.p.k, me vendndodhje: Në përroin e Plepit, Njësia Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sipas këtyre koordinatave:

3. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor: Në përroin e Plepit, Njësia Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

**HEC "PLEPI"**

**Vepra e marrjes 1**

- X = 527268
- Y = 4585942
- Z = 1503.4 m.m.n.d
- $Q_1$ mes =0.252 $m^3/s$
- $Q_1$ eko =0.048 $m^3/s$
- $Q_1$ llog =0.396 $m^3/s$

**Vepra e marrjes 2**

- $X = 528547$
- $Y = 4585530$
- $Z = 1322$ m.m.n.d
- $Q_2$ mes =0.14 $m^3/s$
- $Q_2$ eko =0.023 $m^3/s$
- $Q_2$ llog =0.263 $m^3/s$

**Godina e Centralit**

- $X = 529462$
- $Y = 4584913$
- $Z = 1015$ m.m.n.d

- Fuqia max e instaluar N = 2285 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike E = 8 520 423 kWh/vit.
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer: Q = 0.659 $m^3/s$

4. Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim hidroenergjetik jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**